



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 110/2013
Prishtinë, më 18.6.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha - Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrëse e ftuar: znj.Mimoza Kusari-Lila, zëvendëskryeministre dhe ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Florent Bakia dhe Arta Isterfi –MTI, Burim Ejupi dhe Darsei Canhasi-INDEP, Qëndresa Mrasori, dhe Gurjeta Zeka, praktikante; Valdete Osmani, “Top Channel”; Naim Krasniqi, “Radio Dukagjini”.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 4 dhe 5.6.2013;
3. Raportim i ministres së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me zbatimin e ligjit për masat mbrojtëse në importe;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 4 dhe 5.06.2013;

Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 4 dhe 5.06.2013, u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i ministres së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me zbatimin e Ligjit për masat mbrojtëse në importe;

Kryetari, theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës, e kemi ftuar ministren e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari-Lila, për të raportuar, lidhur me zbatimin e Ligjit për masat mbrojtëse në importe, pasi që grupi punues i Komisionit, ka bërë disa aktivitete dhe takime me përfaqësuesit e shoqatave të ndryshme. Po ashtu, kemi organizuar edhe një dëgjim publik më të gjitha palët e interesit, që kanë të bëjnë me këtë Ligj. Për t'u njoftuar se a po zbatohet ligji, dhe në cilat dispozita po hasin në problem gjatë zbatimit, sot kërkojmë nga ministrja, të raportojë para komisionit, të cilës më pas ia dha fjalën.

Mimoza Kusari-Lila, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, bëri një prezantim në vija të përgjithshme, lidhur me zbatimin e Ligjit për masat mbrojtëse në importe. Ajo tha, që në përgjithësi Ligji është zbatuar, por kemi hasur në disa probleme, duke cekur kuotën e përqindjes prej 25%, për prodhuesit individualë, që duhet t'i përmbushin nevojat e tregut dhe kuotën prej 50%, për prodhuesit grupor. Ajo më tej shtoi se këto kritere, si parakushte janë të vështira për të u plotësuar dhe realizuar me këtë përqindje kaq të lartë, qoftë nga prodhuesit individualë, apo aksionarët. Pastaj, ajo në mënyre kronologjike, i njoftoi deputetët se vetëm masa mbrojtëse ndaj importeve të çimentos është ndërmarrë nga MTI-ja deri më tani dhe mbeten ende sfiduese, për ti mbrojtur prodhimet bujqësore nga importuesit, sepse ende nuk kemi të dhëna statistikore se sa munden t'i përmbushin prodhuesit vendorë, kërkesat me produktet bujqësore, për nevojat e brendshme të Kosovës dhe për shkak të informalitetit, nuk po mund t'i sigurojmë të dhënat, qoftë nga ATK-ja, apo nga Dogana. Në fund, ajo tha se kemi pas edhe kërkesa tjera për të aplikuar masat mbrojtëse, por kur kemi hulumtuar, vërtetuar se ato bien në sferën e dampingut dhe nuk kemi ndërmarrë masa të tjera. Ministrja Kusari-Lila, tha se MTI-ja është e gatshme ta bëjë edhe amendamentin e ligjit, nëse një gjë e tillë del si rezultat i monitorimit të këtij ligji.

Kryetari, pyeti se a ka identifikuar MTI-ja gjatë zbatimit të ligjit, ndonjë nen apo dispozitë, si pengesë për të filluar më plotësim ndryshimin e Ligjit për masat mbrojtëse në importe?

Visar Ymeri, kërkoi që nga ligji të hiqet parakushti dhe kriteri prej 25% dhe 50%, për prodhuesit individualë dhe gruporë, pasi më këto kushte me ligj, ne po i eliminojmë prodhuesit vendorë, duke mos i lenë të ngritën dhe të zhvillohen me prodhimet vendore. Ai tha, që masat mbrojtëse janë për ta evituar rrezikun që vije nga importuesit, prandaj, masa mbrojtëse në ekonomi vije atëherë kur gjërat mund të përkeqësohen. Ymeri theksoi se mënyra më e mirë, me ligj është të rregullohet, që prodhuesve vendorë t'u sigurohen masa mbrojtëse në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe pyeti ministren, se a po nënkuptohet, që ky ligj nuk i është përshtat rrethanave të vendit?

Teuta Sahatqija, tha se grupi punues, gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe, ka pas takime më një numër të prodhuesve vendorë. Kritikën e tyre kanë të bëjnë rreth politikave fiskale, që janë shumë të larta. Po ashtu, për kriterin dhe kuotën që janë në

ligj prej 25%, për prodhuesit individualë dhe 50 %, për prodhuesit gruporë, andaj, kërkesat e tyre, theksoi ajo, janë që këto parakushte të hiqen nga ligji dhe pyeti se kanë pas kërkesa, që të mbrohen prodhimet bujqësore dhe a kanë pas kërkesa nga shoqata e IT-së, që të lirohen nga tatimet, pasi që shërbimet tyre po rrezikohen nga konkurrenca jo e barabartë?

Ramiz Kelmendi, tha se MTI-ja gjatë zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe, para së të marrë vendim për ndalimin e ndonjë produkti, si masë mbrojtëse nga importi, duhet ta analizojmë mirë tregun, se a munden prodhuesit vendorë dhe a kanë kapacitet të prodhimit për t'i mbuluar nevojat e tregut, në mënyrë që mos të lejohet ngritja e çmimeve të produkteve që i dëmton konsumatorët. Ai kërkoi, që më anë të këtij ligji, MTI-ja ti shikojë mundësitë, që t'i mbrojë prodhuesit bujqësorë, gjatë periudhës që mund të ketë prodhime bujqësore, që mund ti plotësojnë nevojat e tregut dhe të konsumatorëve.

Hashim Deshishku, tha se meqenëse, me disa prodhime nuk mund t'i plotësojmë kushtet për pjesëmarrje në treg, deri në 25% dhe 50% , për prodhuesit individualë dhe gruporë, ai shtoi se në prodhimtarinë dhe përpunimin e drurit, munden, qoftë në mënyre individuale, qoftë atë grupe, t'i përmbushin kriteret e parapara më ligj, nëse shteti do ti mbështeste më politika fiskale. Kërkoj për prodhuesit vendorë, që për makineritë prodhuese dhe për lëndë të parë, të paktën të ju hiqet taksa doganore. Deshishku pyeti se a janë kthyer 30% të taksës për prodhuesit e drurit?

Myzejene Selmani, tha se sa i përket çështjes së politikave fiskale, që po ceken nga parafolësit, kjo nuk varte vetëm prej MTI-së, që mund të bëjë këtë zgjedhje, por kjo varet prej Ministrisë së Financave. Prandaj, këtu Qeveria duhet ta ndryshojë qasjen në politikat fiskale. Selmani shtoi se sa i përket zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe, duhet të kemi masat mbrojtëse në lëndën e parë prodhuese, mirëpo, siç u cek edhe me lartë, nuk i takon zbatimi i këtij ligji vetëm MTI –së, por në tërësi edhe dikastereve tjera të shtetit.

Ministrja, **Mimoza Kusari-Lila**, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të deputetëve, tha se në një aspekt, mbulimi i tregut na paraqet problem, pasi MTI-ja; MF-ia dhe Administrata Tatimore dhe Dogana, nuk kanë informata dhe të dhëna të sakta statistikore, se sa mund ta mbulojnë tregun prodhuesit bujqësorë. Por, ne me këtë ligj i përcaktojmë kushtet dhe rregullat sipas të atyre të BE-së dhe të Organizatës Botërore për Tregti, prandaj, në disa raste duhet t'ju përmbahemi rregullave, dhe jo gjithherë mund të marrim vendime në favor të mbrojtjes së prodhuesve vendorë. Sa i përket plotësimit dhe ndryshimit të ligjit, po e shikojmë mundësinë, që të fillojmë me procedurat e amendamentimit të atyre neneve, që po na paraqesin pengesë në zbatim. Ajo tha se për prodhuesit bujqësorë, posa t'i keni të dhënat statistikore, se në cilën periudhë të vitit mund ti përmbushin nevojat brendshme të konsumit, atëherë do të shohim mundësitë që nuk bien ndesh më marrëveshjen e CEFTA-s, të marrim vendim për masat mbrojtëse nga importuesit, por në këtë aspekt, kemi probleme edhe me ekonominë informale. Për kapacitetet e prodhuesve vendorë, tha se ato janë shume të vogla dhe nuk mund ti përmbushin të gjitha nevojat e tregut. Për taksën doganore, tha se doganat nganjëherë kanë mospërputhje, duke përdorur kode të ndryshme të zhdoganimit, por kjo çështje është kompetencë e MF-it, dhe nëse ka politika favorizuese për kompanitë e ndryshme, atëherë ju mbetet organeve të drejtësisë, për të hetuar këtë çështje. Për lëndën e parë dhe makinerinë prodhuese, tha që ju kemi rekomanduar MF-it dhe doganave që të hiqet taksa doganore prej 10%, ndërsa të mbulohet në ndonjë mall tjetër si psh. në duhan, sepse janë vetëm 18 milionë euro të hyra, nga zhdoganimi i makinerive, një shumë, e cila mund lehtë të mbulohet.

Kryetari, në fund të mbledhjes, tha që ky është takimi i fundit që e ka paraparë grupi punues, në agjendën dhe në planin e punës, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe. Ai theksoi se grupi punues do ta mbajë edhe një mbledhje për ti shqyrtuar dhe analizuar të gjitha raportet e takimeve dhe transkriptin e dëgjimit publik, për ti parë propozimet e

të gjitha palëve të interesit. Ai propozoi që të hartohet raporti final me rekomandime, për miratim të mëtutjeshme në Komision dhe në seance plenare, sipas procedurave të Rregullores të punës së Kuvendit.

Komisioni njëzëri vendosi këtë

Konkluzion:

Grupi i punës të hartojë Raportin me Rekomandime, që të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetari, i njoftoi deputetët për ftesën e dërguar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, më 4 korrik 2013, me ç'rast do të mbahet mbledhja e parë e parlamentarëve nga Palët Kontraktuese - Miqtë e Komunitetit të Energjisë. Dhe, në bazë të konsultave me deputetë, do të caktojë një delegacion për të përfaqësuar Komisionin në këtë Konferencë.

Deputetët u pajtuan me propozimin e kryetarit.

Lutfi Zharku, propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohen anëtarët e Bordit të Autoritetit të Konkurrencës, për shkak të disa shqetësimeve që i kanë paraqitur përmes letrave të dërguara.

Deputetët u pajtuan me propozimin e z.Zharku.

Myzejene Selmani, kërkoi nga kryetari, që të procedohet tutje Projektligji për tregun dhe produktet e naftës.

Kryetari, tha se kjo çështje është në Kryesi të Kuvendit dhe varet nga kryesia se kur do ta procedojnë në seancë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetar i Komisionit
Zenun Pajaziti**